



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.291, datë 23.09.2021

**“MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË KANDIDATES  
PËR T’U PRANUAR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR  
TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR  
VITIN AKADEMIK 2021-2022  
ZNJ. ENKELEJDA MEÇKA**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 1, të nenit 159, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, germa “a”, të pikës 8, të Seksionit Ç, të Kreut VI, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, e miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të znj. Enkelejda Meçka, kandidate për t’u pranuar në programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të konsiderojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidates znj. Enkelejda Meçka për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022, sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidates znj. Enkelejda Meçka për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022.
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Enkelejda Meçka dhe Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA





**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR  
MOISI DUDA**

**ANËTAR  
VATË STAKA**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**